



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 409/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bajram Latifi anëtarë i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, paraqitur kundër subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS) dega në Prizren, për shkak të shënimit të grafitëve në shtëpinë private, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Bajram Latifi.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 31.10.2013 ka pranuar një ankesë nga Bajram Latifi anëtarë i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, në të cilën theksohet se mes 29 dhe 30 tetorit 2013 me ngjyrë të zezë është demoluar dera kryesore hyrëse në shtëpinë e tij në Prizren në rrugën e “Ajdin Rrahmanaj” nr 25 ku ai jeton së bashku me tre bashkëpronaret e tjerë. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se mbishkrimi është shënuar me ngjyrë të zezë dhe është shkruar fjala “ NDS 97 “ e cila shkurtesë është Nova Demokratska Stranka. Parashtuesi i ankesës thekson se ky akt është i motivuar pasi që ai është anëtarë i KQZ-së dhe se me këtë veprim familja e tij është shqetësuar psikikisht si dhe ju është dëmtuar prona private dhe është rrezikuar integriteti personal dhe ai familjar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesë pretendon se militantë të subjektit politik NDS, kanë shënuar grafitë në shtëpinë e tij në Prizren. PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të mjaftueshme të cilat eventualisht do ti argumentonin pretendimet e tilla ankimore sepse fotot e ofruara si prova që gjendet në shkresat e lëndës nuk janë të mjaftueshme për tu vërtetuar pretendimet e tilla andaj një ankesë e tillë është e pabazë dhe se një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si përgjithshëm dhe i pa argumentuar mirë në fakte dhe në dëshmi konkrete bindëse. Andaj PZAP-i duke u mbështetur në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 409/2013 më datën 04.11.2013

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*